

STATUT

I

SHOQËRISË TREGTARE "ALMART" Sh.p.k.

Sot më date 04. 09.2025 shoqëria tregtare "M A R T I N I" Sh.p.k, person juridik shqiptar, i identifikuar me NIPT J61918015U, me seli në adresën: Rruga "Gjergj Legisi", Nr. 10, Laprake, Tiranë, e përfaqësuar nga Administratori dhe njëkohësisht ortak i vetëm i saj z. **Agim Ramaj**, lindur në datë 30.09.1957, i identifikuar me numrin personal F70930088K, themelon shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emrin "ALMART" dhe vendos të miratojë e të nënshkruajë këtë statut.

KREU I

ORTAKËT, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA.

Neni 1

Ortakët e shoqërisë

Ortak i vetëm i shoqërisë "ALMART" Sh.p.k është shoqëria "MARTINI" Shpk me NIPT J61918015U, përfaqësuar nga Agim Ramaj.

Neni 2

Personaliteti juridik

1. Shoqëria "ALMART" Sh.p.k. nga këtu e më poshtë referuar si shoqëria, e fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Shoqëria është person juridik shqiptar e cila zhvillon aktivitetin në përputhje me ligjin 9901, dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe këtë statut.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë "ALMART" është:

Import-eksport te profileve te aluminit, aksesoreve te aluminit, metalik dhe inoksi.

Shitja dhe tregtimi i tyre me pakice apo shumice, ngjyrosja dhe lyerja e tyre etj. Magazinim profile alumini dhe aksesoret te ndryshem te sistemeve te aluminit. Tregtim me shumice e pakice, import-eksport te te gjitha llojeve te lingotave e profileve te aluminit e aksesoreve perkates te tyre, prodhimeve te plastikës apo të drurit qe lidhen me to, konstruksione e pajisje metalike, materiale dekorative te cdo lloji, bojra, preparate te ndryshme per ngjyrosje, xhama, pasqyra, ambalazhe plastike, skrap alumini, metalik, etj. Shoqeria do te realizoje procesin e ngjyrosjes te



te gjitha llojeve te profileve si dhe prodhimin e dyerve, dritareve, vetratave e fasadave te ndryshme sipas kerkeses se tregut.

Import - Eksport i paneleve te kompozitit alumin, HPL, Pllaka porcelani dhe te gjitha nenproduktet te tjera te sistemeve perkatese per fasadat dhe aksesoret e tyre.

Transportin kombetar dhe nderkombetar te mallrave per nevojat e veta dhe te treteve. Import-eksport, blerje shitje, tregti, montim dhe shfrytezim i paneleve diellore dhe i aksesoreve te tyre. Prodhim i energjise nga panelet diellore dhe perdorimin e saj per nevojat e shoqerise. Shitje blerje dhe tregti e energjise se prodhuar nga panelet diellore tek te tretet.

Import-eksport dhe tregtim i cdo materiali ndertimi si dhe malli me kete prejardhje dhe kryerja e sherbimeve perkatese. Ndertim i objekteve multifunkionale, per banim, i qendrave tregtare. Shoqëria mund të marrë te drejtën e përfaqësimit në Shqipëri të individëve, shoqërive apo organizatave vendase apo të huaja.

Projektim inxhinierik i fasadave, termoizolimeve, hidroizolimeve dhe strukturave të ndryshme rezidenciale apo komerciale..

Shoqëria mund të ofrojë asistencë teknike ne ndjekjen e procedurave të përpunimit dhe zbatimit të kontratave të klientëve të saj.

Për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, shoqëria mund të kryejë në rrugë ndihmëse dhe jo parësore, të gjitha operacionet industriale, financiare dhe tregtare mbi pasuri të luajtëshme apo të paluajtëshme në shqipëri dhe jashtë saj, në masën që vlerësohet e dobishme dhe /ose e përshtatshme nga organi administrativ, dhe mundet gjithashtu të marrë përsipër ne mënyrë ndihmëse pjesmarrjen në kapitalin themeltar të shoqërive ose ndërmarrjeve të tjera, dhe/ose enteve të themeluara ose që do të themelohen me object të ngjashëm, të afërt ose të lidhur me të vetin, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 4

Selia e shoqërisë

1. Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Rruga Bashkimi European, Vore, Marqinet, Lagjia Marqinet 1032, Godine 2-kateshe, Magazine, Zona Kadastrale 2605, Shqiperi.
2. Shoqëria mund të shtrijë aktivitetin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të themelojë degë ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.
3. Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

Neni 5

Vula dhe logo

Shoqeria do te kete vulën dhe logon e saj te cilat do te miratohen me vendim te Administratorit te Shoqerise.



Neni 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

1. Periudha e aktivitetit të shoqërisë është pa afat.
2. Çdo ndryshim në lidhje me periudhën e kohëzgjatjes së aktivitetit mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve të Shoqërisë.

KREU II

KAPITALI

Neni 7

Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 10 000 000 (dhjetë milion) lekë.
2. Kapitali themeltar përbehet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale 10,000,000 (dhjetëmilion) lekë.
3. Pjesëmarrja me kuota e ortakut të vetëm është si më poshtë:
 - Shoqëria "M A R T I N I" Shpk zotëron 1 kuotë të barabartë me vlerë nominale 10,000,000 (dhjetëmilion) Lekë ose 100 % të kuotave të shoqërisë "ALMART" Sh.p.k.
4. Kapitali themeltar do të paguhet plotësisht pas regjistrimit të shoqërisë kur ajo të ketë fituar personalitetin juridik.

Neni 8

Modalitetet e zmadhimit të kapitalit

1. Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicën e parashikuar për ndryshimin e këtij statuti.
2. Kapitali themeltar zmadhohet nëpërmjet emetimit të kuotave të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të kuotave ekzistuese.
3. Kuotat e reja shlyhen me para në dorë, me kompensim të një kredie në para të kërkueshme dhe të detyrueshme për t'u shlyer nga shoqëria, me përfshirje të rezervave, fitimeve apo primeve të emetimit, me kontribut në natyrë etj.
4. Mund të derdhen për llogari të zmadhimit të kapitalit të gjithë elementët e aktivitetit që mund të nënshtrohen vlersimit ekonomik, me përjashtim të kontributeve në shërbime në favor të shoqërisë. Vendimi për zmadhimin duhet të përcaktojë modalitetet e derdhjes së kontributeve: në mungesë të cdo udhëzimi, zmadhimi kryhet në kontribute në para.
5. Ortaku/ortakët vlerëson kontributet në natyrë dhe i shpreh vlerat e tyre në para.



Neni 9

Modalitetet e zvogëlimit të kapitalit

1. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.
2. Zvogëlimi i kapitalit prek ortakun/ortakët në të njëjtën masë në përpjesëtim me vlerën e kuotave që zotërojnë.
3. Projekti i zvogëlimit të kapitalit komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar të paktën 45 ditë përpara mbledhjes së asamblesë së ortakëve që thirret për të vendosur mbi këtë projekt.

Neni 10

Regjistrimi i veprimeve mbi kuotat

Pronësia mbi kuotat dhe veprimet mbi të regjistrohen në regjistrin që shoqëria mban për këtë qëllim dhe që përmban detyrimisht të dhënat e mëposhtme:

- a- Emrin, mbiemrin, numrin e identifikimit dhe adresën e pronarit të kuotës;
- b- Vlerën nominale dhe numrin e kuotave në pronësi;
- c- Emrin, mbiemrin, numrin e identifikimit dhe adresën e pronarit të ri të kuotës në rast transferimi;
- d- Të dhënat e kontratës me të cilën është bërë transferimi i pronësisë mbi kuotën.

Neni 11

Transferimi i Kapitalit

1. Kuotat mund të transferohen lirisht midis Ortakeve.
2. Transferimi i kuotave të kapitalit të shoqërisë tek të tretët, realizohet pas miratimit të dhënë paraprakisht nga Asambleja e ortakëve të shoqërisë, e cila vendos me $\frac{3}{4}$ e kuotave të kapitalit të shoqërisë.
3. Transferimi i Pjesëve të Kapitalit tek të tretet janë objekt i të Drejtës së Parablerjes në favor të Ortakeve të tjerë eventuale.
4. Procedura e mësipërme nuk do të zbatohet për transferimet nga një Ortak tek një shoqëri e kontrolluar prej tij (te pakten në masën 51% të kapitalit), ose për një transferim nga një Ortak tek një paraardhës apo pasardhës i drejteperdrejte i tij apo tek bashkëshorti/ja.
5. Çdo transferim apo zoterim i Kuotave, ashtu si dhe krijimi apo transferimi i çdo të drejte tjetër mbi to, duhet të regjistrohen në Regjistrin e Ortakeve dhe në QKB.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE



Neni 12

Organet e shoqërisë

Drejtimi dhe administrimi i shoqërisë bëhet nëpërmjet organeve të saj që janë:

- Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- Administratori/Administratorët.

Neni 13

Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) shitjen e pasurive të paluajtshme të shoqërisë;
 - j) blerjen e pasurive të paluajtshme;
 - k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
3. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

Neni 14

Thirrja e mbledhjes së asamblesë

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
2. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga Administratori, ortaku i vetëm ose likuiduesi.



Neni 15

Mënyra e njoftimit

1. Kur Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori jo ortak i shoqërisë, kjo bëhet nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, e t'u dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Bashkë me njoftimin ortakëve u duhet dërguar edhe dokumentacioni që ka lidhje me rendin e ditës.
2. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendim, pavarësisht parregullsisë.

Neni 16

Përfaqësimi i një ortaku

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi, nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Neni 17

E drejta e votës

1. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
2. Ortakët që nuk janë të pranishëm fizikisht mund të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së Përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike.
3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
 - a- Transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
 - b- Komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
 - c- Mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Neni 18

Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë

1. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.



2. Procesverballi duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës emrin e kryesuesit të mbledhjes dhe të mbajtësit të procesverbalit, si dhe rezultatet e votimit.
3. Kryesues i mbledhjes mund të jetë njëri prej ortakëve ose personi që ka thirrur mbledhjen, ndërsa mbajtësi i procesverbalit (sekretari) zgjidhet nga kryesuesi i mbledhjes.
4. Procesverballi i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si dhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.
5. Procesverballi i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Neni 19

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave.
2. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë një shumicë të kualifikuar sipas nenit 20 të këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo mjete elektronike.
3. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 e 2 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

Neni 20

Marrja e vendimeve

1. Asambleja e Përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shitjen e pasurive të paluajtshme të shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Për çështjet e tjera të renditura në këtë Statut, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë statut.

Neni 21

Administratori, emërimi dhe kohezgjatja

1. Administratori është individ/person fizik që mund të zgjidhet brenda apo edhe jashtë bashkësisë së ortakëve të shoqërisë.
2. Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
3. Akti për emërimin e Administratorit përcakton gjithashtu dhe kohën e qëndrimit në detyrë të tij. Nëse kjo nuk është e përcaktuar në aktin e emërimit, kjo periudhë nuk mund të jetë më e gjatë se 5 vjet, duke filluar ky afat nga data e emërimit.



4. Në rast dorëheqje/shkarkimi Asambleja e Përgjithshme, jo më vonë se 2 javë nga momenti i njoftimit të dorëheqjes ose shkarkimit emëron me vendim Administratorin e ri të shoqërisë.

Neni 22

Kompetencat e Administratorit

1. Administratori në mënyrë individuale ka kompetenca të plota për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë, gjithmonë brenda objektit të aktivitetit të shoqërisë duke u kufizuar në ato kompetenca që ligji ose ky statut ia jep shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme.
2. Administratori i shoqërisë ka këto të drejta dhe detyrime:
 - a- Përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
 - b- Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
 - c- Miraton rregulloret përkatëse të punës, si dhe emëron e shkarkon punonjësit e shoqërisë;
 - d- Merr me qira ambiente për shoqërinë si dhe mund të japë me qira ambientet e shoqërisë.
 - e- Miraton pagat e punonjësve.
 - f- Përcakton tarifat e shërbimit si dhe blen e shet në emër të shoqërisë pasuri të luajtshme.
 - g- Për plotësimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë përveç angazhimit të punonjësve të saj, mund të angazhojë me kontrata shërbimi dhe ekspertë të tjerë;
 - h- Kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - i- Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - j- Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërkojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - k- Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për "Qendrën Kombëtare të Biznesit";
 - l- Raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
3. Shitja dhe/ose blerja e pasurive të paluajtshme do të konsiderohet e vlefshme nëse për të është marrë pëlqimi paraprak i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Në këtë rast vendimi përkatës i Asamblesë do të konsiderohet i vlefshëm, nëse ortakët që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e kapitalit të shoqërisë kanë votuar në favor të shitjes dhe/ose blerjes së pasurisë në fjalë.
4. Administratori përgjigjet për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve të shoqërisë, duke përfshirë vendimet dhe procesverbalet e Asamblesë së Përgjithshme.



Neni 23

Shkarkimi i Administratorit

1. Administratori shkarkohet për shkaqe të përligjura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas nenit 95, pika 6 e ligjit nr.9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
2. Do të konsiderohen shkaqe të përligjura të gjitha veprimet me faj të rëndë të Administratorit, paaftësia e tij në kryerjen korrekte të funksioneve, moszbatimi hapur i vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, mosrespektimi i Statutit të shoqërisë dhe dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare, si edhe çdo veprim i Administratorit, i cili dëmton ose mund të dëmtojë rëndë interesin e shoqërisë.

Neni 24

Administratori i parë i shoqërisë

Administratori i parë i shoqërisë për një periudhë 5 vjetecare duke filluar nga data e regjistrimit të këtij statute në QKB është:

Z. BESIION PËRPUNJA

shtetas shqiptar, lindur më 06.06.1988 në Tiranë dhe banues në Tiranë identifikuar nga letërnjoftimi me nr. personal I80606073W.

KREU IV

VITI FINANCIAR - EKSPERTET

Neni 25

Viti financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon në datën e parë të muajit Janar dhe përfundon në ditën e 31-të të muajit Dhjetor të secilit vit. Viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 26

Ekspertët kontabël të autorizuar

1. Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga një ekspert kontabël i autorizuar.
2. Ekspertët kontabël të autorizuar emërohen për një vit financiar. Funksionet e tyre përfundojnë pas mbledhjes së asamblesë e cila merr vendim mbi llogaritë vjetore.
3. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai ka kryer një gje të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve.



4. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabël I autorizuar përgatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ia paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën te drejtës vendimore qe kanë.

Neni 27

Përgjegjësia e ekspertëve

1. Ekspertët kontabël të autorizuar janë përgjegjës si ndaj shoqërisë, ashtu dhe ndaj të tretëve për pasojat e dëmshme që rrjedhin nga fajet dhe nënvlerësimet e tyre në ushtrimin e funksioneve përkatëse.
2. Ata nuk janë ligjërisht përgjegjës për shkeljet e ligjit të kryera nga administratori, me përjashtim të rasteve kur kanë pasur dijeni për to, por nuk i kanë zbuluar në raportin për mbledhjen e asamblesë.

Neni 28

Shpërndarja e fitimeve

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.
2. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

Neni 29

Kufizimet e shpërndarjeve, certifikata e aftësisë paguese

1. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
 - a- Aktivët e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b- Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
2. Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.
3. Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

KREU V

PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 30

Prishja e shoqërisë

Shoqëria do të priset:



- a- Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- b- Me hapjen e procedurave të falimentimit/likuidimit;
- c- Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723, dt. 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".
- d- Me vendim të gjykatës kompetente.

Neni 31

Likuidimi i shoqërisë

Likuidimi i shoqërisë kryhet në përputhje dhe në respektim të kushteve dhe procedurave të parashikuara nga dispozitat përkatëse ligjore.

Neni 32

Riorganizimi i Shoqërisë, Bashkimi, Ndarja

Shoqëria mund të ndahet ose të bashkohet sipas vendimit të Asamblese së Përgjithshme, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2012 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 33

Ligji i zbatueshëm

Për të gjitha çështjet për të cilat Statuti nuk parashikon rregullim në mënyrë të posaçme do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çdo ligj tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 34

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe organeve të tjera të shoqërisë dhe që kanë si objekt të drejta të disponueshme në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKU I VETËM

Shoqëria "MARTINI" Sh.p.k

**Përfaqësuar nga
AGIM RAMAJ**

Agim Ramaj

